



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Paraprak Përqendrimi

#### **Rasti: Bashkim me përthithje: Banka Amerikane e Investimeve SHA / Banka NBG ALBANIA SHA**

Me shkresën Nr. 92 Prot., datë 07.02.2018, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Kontratë për Shitje dhe Blerjen e Aksioneve”. Me anë të kësaj Kontrate, të nënshkruar me datë 02.02.2018, është realizuar bashkimi me përthithje i shoqërisë Banka NBG Albania SHA (Target) nga shoqëria Banka Amerikane e Investimeve SHA (Blerësi).

Ky njoftim plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Palët pjesëmarrëse në transaksion :

- Shoqëria Banka Kombëtare e Greqisë S.A. (NBG Greece), (**Shitësi**), një shoqëri anonime e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Greqisë, me seli në adresën Aiolou 86, Athinë, 10232, Greqi.
- Shoqëria Banka Amerikane e Investimeve SHA, (ABI Bankë), (**Blerësi**), krijuar dhe regjistruar si entitet ligjor shqiptar, me NUIS J91725007P dhe adresë në Rrugën e Kavajës, Nr. 27, Tiranë. ABI Bankë zotërohet nga shoqëria Tranzit SHPK.
- Shoqëria Banka NBG Albania SHA, (**Target**), është një shoqëri aksionare e krijuar sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Banka NBG Albania SHA është e regjistruar me NUIS J61911008C dhe adresë në Rrugën Dritan Hoxha, Hd.8, H.1, Tiranë. Banka NBG Albania SHA zotërohet tërësisht nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A. (NBG Greece).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**